



## Departamenti i Prokurimit

**Prishtinë: datë, 30.03.2023**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **30.03.2023** të parashtruar nga **OE “Shkelqimi 07”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizimi me fidane dhe lule dekorative shumevjeqare për hapsirat publike dhe parqet”**, me Nr. të Prok: **616-23-956-1-1-1** dhe numër te brendshëm **616-23-17-111** nxjerr:

### VENDIM

**Aprovohet si pjeserishte e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e **OE “Shkelqimi 07”** të dt. 30.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi me fidane dhe lule dekorative shumevjeqare për hapsirat publike dhe parqet”**, me Nr. të Prok: **616-23-956-1-1-1** dhe numër te brendshëm **616 22 017 111**, kundër *Njoftimit për kontrate*, të datës 10.03.2023.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te beje korigjim te procedures lidhur me aktivitetin e prokurimit per tenderin* **“Furnizimi me fidane dhe lule dekorative shumevjeqare për hapsirat publike dhe parqet”**, me Nr. të Prok: **616-23-956-1-1-1** dhe numër te brendshëm **616 23 017 111**.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

**OE “Shkelqimi 07**, me datë 30.03.2023, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizimi me fidane dhe lule dekorative shumevjeqare për hapsirat publike dhe parqet”**, me Nr. të Prok: **616-23-956-1-1-1** dhe numër te brendshëm **616 23 017 111**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 30.03.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet ankimore te OE "Shkëlqimi 07" janë pjesërisht te bazuara andaj AK duke u mbështetur ne Parimet e përgjithshme te LPP , përkatësisht ne nenin 7 Barazia ne trajtim / jo diskriminim qe thotë se AK do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabarte jo diskriminuese dhe ne mënyrë transparente, do te beje korrigjimin e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1&9.2 – pika 4.

Ne Dosjen e tenderit te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika (9.1&9.2 - pika 4 është kërkuar qe: **OE duhet te dëshmoj se produktet e kërkuara ne dosjen e tenderit janë me prejardhje nga vendet e BE** dhe si dëshmi duhet te dërgohet: **Kopja e certifikatës fitosanitare te cilat dëshmojnë se produktet e ofruara janë nga vendet e BE-se.**

AK do te korrigjoj këtë kriter i cili korrigjim do te jete ne Formularin B54 – Formulari për korrigjimin e njoftimeve te publikuara, i ngarkuar ne platformën e E-Prokurimit

Pretendim i dyte: se AK ka vendosur ne paramasen vetem çmimin njesi por jo sasite, ky pretendim eshte i paqendrueshem per faktin qe AK ka pergaditur specifikimin teknik gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne rregulloren per Prokurim Publik, andaj edhe ne LPP dhe ne Rregulloren per prokurim publik nuk shkruan askund se paramasa per furnizime me çmim njesi eshte e ndaluar.

Citojme nenin: 54.15 te Rregullores 001/22, Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, *kontratat me çmime për njësi*, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. në këto raste nuk vlen pragu apo tavani *plus/minus tridhjetë përqind (30%)*, si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shumë fikse. **Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje).**

Pretendimi i tretë lidhur me materialin e vazove, po ahtu eshte i paqendrueshem tjera per faktin qe ju si OPE nuk jeni kompetente per percaktimin e materialeve te prodheteve te kerkuara nga ana e AK. Specifikimet teknike i harton **njësia kërkuese e cila njësi përbehet prej eksperteve profesional ne fushën e mjedisit te cilët edhe e kane parapare një gjë te tillë, andaj ky lloj i materialit te vazove dhe artikujve tjerë mbeten te njëjti siç është dhënë ne përshkrimin e çmimit – specifikimin teknik.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

